Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë

Departamenti i Gjeografisë

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE

JSTOR

FUSHA E APLIKIMIT: Turizmi

"Dumrea: vendi i liqeneve, destinacioni më i ri turistik në Shqipëri"

Punoi: Oksana Sallja

Master Shkencor Gjeografi, Viti I

Tiranë 2021

HYRJE

Zona e Dumresë shtrihet në verilindje të Pllajës Dumre-Darsi, pjesë e Rajonit Perëndimor të Shqipërisë. Kjo zonë ka një sipërfaqe prej 215 km², ku përfshihen mbi 40 fshatra dhe një qytet. Dumrea, e pozicionuar në zemër të Shqipërisë, është nën administrimin e Bashkisë Belsh, një bashki e re, e formuar pas reformës Administrative territoriale në vitin 2015, e cila përfshin 5 Njësi Administrative: Belsh, Fierzë, Grekan, Kajan dhe Rrasë. Kjo zonë në hapsirën e saj gjeografike përfshin edhe Njësinë Administrative Shalës, pjesë e Bashkisë Cerrik, e cila gjithashtu është formuar pas reformës Administrative territoriale në v.2015.

Dumrea, është një zonë e cila përmban potenciale të shumta natyrore e kultore, të ofrojnë mundësi për një zhvillim të qëndrueshëm pothuajse në të gjithë sektorët ekonomik, sidomos në turizëm. Turizmi ka marrë një rëndësi të veçantë kohët e fundit, si rezultat i zhvillimit ekonomik që po i siguron zonës. Kjo degë, e cila po njeh zhvillim këto 4 vitet e fundit, nuk ka një zhvillim të njëtrajtshëm kudo, për shkak se kjo varet nga mundësitë dhe kushtet që i krijojnë hapësirat e ndryshme në zhvillimin e tij. Politikat e ndërmarra gjatë kësaj periudhe e kanë shndërruar Dumrenë në një ndër destinacionet më të vizituara nga turistët vendas dhe të huaj.

Cështjet që do të trajtohen në këtë punim janë;

- Roli i kushteve natyrore në zhvillimin e turizmit në Dumre;
- Zhvillimi i turizmit në Belsh dhe ndikimi i saj në zhvillimin e gjithë Dumresë;
- Llojet e turizmit që zhvillohen falë potencialeve natyrore dhe kulturore të zonës;

Shkurtimet;

PPV - Plani i Pergjithshem Vendor

POZHL - Plani operacional për zhvillimin local

S.T.K – Sektori i turizmit dhe kultures

Shënim; - Të gjitha imaget e përdorura në këtë punim janë marrë nga interneti...

Dumrea: vendi i liqeneve, destinacioni më i ri turistik në Shqipëri

I. Roli i kushteve natyrore në zhvillimin e turizmit në Dumre

Zona e Dumresë kufizohet në jug me Bashkinë Kucovë, në veri me Bashkinë e Peqinit, në lindje Fushën e Elbasanit dhe në perëndim me Bashkinë Lushnjë (PPV, Bashkia Belsh, 2019). E pozicionuar në qëndër të Shqipërisë, ajo ndodhet në afërsi të disa qyteteve të mëdha e të rëndësishme si; - Elbasani dhe Lushnja (23 km larg), Tirana (60 km), Durrësi (70 km), Berati (25 km), etj. (PPV, Bashkia Belsh, 2019). Kjo afërsi ka shërbyer si faktor ndikues në shtimin e vizitorëve vendas vitet e fundit, të cilët gjatë fundjave vijnë dhe vizitojnë këtë perlë të vendit të tyre. Një perlë, e cila ishte harruar, por falë investimeve të bëra sidomos gjatë 4 viteve të fundit e rikthyen përsëri në jetë, duke e shndërruar në destinacionin me të ri turistik.

Përsa i përket potencialeve natyore që zona ofron, mund të themi që janë mjaft favorizuese për zhvillimi e turizmit. Në Dumre shtrihet një reliev kryesisht i rrafshët, i përbërë nga kodra jo shumë të larta, të cilat i japin pamjen e sistemi kodrinor, prandaj shpesh herë e hasim në literatura të ndryshme si një zonë kodrinore. Ky sistem kodrinor ndahet nga gropa, fushëgropa e liqene të shumta (Akademia e Shkencave. 1990).

Territori i Dumresë dallohet për një hidrografi mjaft të pasur me liqene, origjina e të cilëve është karstike (Akademia e Shkencave.1990). Sipërfaqja e tyre e përgjithshme është rreth 770 ha ose zënë rrëth 3% të sipërfaqes së përgjithshme të gjithë Dumresë. Dumrea, njihet ndryshe edhe si *"Vendi i Liqeneve"*. Pikërisht, origjina e tyre ka shërbyer si një ndër arsyet në rritjen e numrit të turistëve, të cilët kishin kureshtje për fenomenin e karstit.

Sipas studimit të një grup autorësh: *"Peizazhet karstike krijohen nga veprimi i ujit në shkëmbinj të tretshëm, kryesisht gëlqerorë dhe dolomite, ku acidi karbonik rrit aciditeti i ujit, duke bërë që ai të shpërndajë karbonatin e kalciumit në shkëmbinj..." (White. W. B. et al., 1995).*

Në Dumre gjenden rreth 84 liqene karstike, numri i të cilëve sa vjen e rritet fal fenomenit të karstit. E vecanta e tyre është jetëgjatësia e tyre gjatë periudhës së thatë të vitit, ku afro 20 liqene thahen përkohësisht dhe mbushen sërish në periudhën e lagësht të vitit (Akademia e Shkencave. 1990). Ky fenomen ndodh sepse ujrat e liqeneve nuk komunikojnë me njeri-tjetrin, pra janë liqene pa rrjedhje dhe e vetmja mënyrë që të ushqehen janë reshjet. Por për shkak se niveli i reshjeve nuk është i lartë, bën që ky fenomen të jetë i përvitshëm dhe gjithnjë e më "agresivë".

Përsa i përket botës bimore kjo zonë, dikur ka qënë e pyllëzuar me pyje dushku, drize, shkozë, frashër dhe me pemë frutore të cilët i jepnim asaj një bukuri të rrallë, por pas formimit të Kooperativave Bujqësore në vitin 1956-1957, kjo zonë ju nënshtrua shpyllzimeve pa kriter të pyjeve, të prerjes e shkuljeve masive të pemëve në ara për ti kthyer ato në toka buke (Doka, Dh., 2015).

Zona e Dumresë është e përbërë kryesisht nga mbulesa bimore të makjes mesdhetare. Gjithashtu ka filluar të rigjenerohen mjaft pyje dushku, si dhe po gjelbërohet e gjithë zona për ta kthyer atë

siç ka qenë dikur. Llojet më të përhapura të bimësisë këtu janë; Mareja, Shkoza, Gjineshtra, Pishat, Plepi, Shelgu etj. Druri që mbizotëron dhe karakterizon Dumrenë është Dushku. Pylli më i madh dhe i njohur në Dumre është ai i Marinës, i cili ndodhet 2 km larg qendrës së Belshit, me një sipërfaqe prej 100 km2 dhe karakterizohet nga pemë të shumta Lisi. Në mes të tij gjendet dhe Liqeni i Marinës që e bën akoma dhe më të bukur e tërheqës këtë vend (PPV, Bashkia Belsh, 2019). Pylli është pastruar dhe sot është në një gjendje shumë të mirë. Nëse përpjekjet duke përdorur turizmin e natyrës për të ruajtur burimet natyrore do të kenë sukses, zona mund të njohi një zhvillim të tillë që duhet të përfshijë njohuri ekologjike në ndërveprimin e shqetësimeve natyrore me sistemet sociale dhe biotike (Savage, M., 1993). Ky pyll ka rëndësi të vecantë për zhvillim e turizmit, i cili me praninë edhe të liqenit të Marinës ka rritur interesat e mjaft vizitorëve, të cilët e vizitojnë atë për një xhiro qetësuese e relaksuese duke shijuar pamjen mahnitësë që natyra ofron.

II. Zhvillimi i turizmit në Belsh dhe ndikimi i saj në zhvillimin e gjithë Dumresë

Zona e Belshit, por edhe zona të tjera të Dumresë, si rrjedhojë e peizazhit dhe burimeve të saj ujore (liqeneve) ka një potencial të madh për të zhvilluar turizmin, por për shkak të mungesës së infrastrukturës së përshtatshme rrugore si dhe mungesës së promovimeve nga autoritetet lokale e kombëtare, ky lloj aktiviteti ekonomik është ende i paeksploruar dhe i pazhvilluar plotësisht. Sidomos në këtë Bashki, turizmi mund të shihet gjithashtu si një fushë e përshtatshme për të rritur pjesëmarrjen dhe integrimin e të rinjve dhe femrave. Turizmi është një degë ekonomie, e cila shihet mjaft ndikuese në integrimin e të rinjve dhe sidomos të gjinisë femërore (Doka,DH., 2019), ku në një vend të vogël si i joni femra gjithmon është ndjerë e pavlerësuar.

Krijimi i itinerareve turistike përgjatë liqeneve të Bashkisë, ngritja e bujtinave pritëse, qendrave agrikulturore, guidave dhe tureve turistike, qendrave të turizmit lokal etj., mund të jenë forma zhvillimi (Doka,DH., 2019), ku ky grup mund të luajë një rol të rëndësishëm në organizimin dhe manaxhimin e tyre.

Me reformën e re territoriale në vitin 2015, Belshi u vendos të lihej Bashki më vete dhe si rrjedhojë e prioritet që prej vitit 2015, ishte turizmi në Dumre (POZHL, Bashkia Belsh,2016). Në zonën e Dumresë ka biznese të ndryshme që i janë në ndihmesë turizmit duke i shërbyer turistëve një mikpritje sic i ka hije traditës së Shqipërise së mesme dhe në vecanti të zonës. Baret dhe restorantet e vogla janë funksionale në të gjitha fshatrat e njësive administrative; Kajan, Fierzë, Rrasë, Belsh, Grekan dhe Shalës. Gjithashtu, në disa fshatra ka filluar krijimi i shtëpive pritëse. Për fatin e mirë shërbimet që ofrojnë lokalet përgjatë rrugës që të çon drejt Belshit janë të një kualiteti që gjithkujt i lë një përshtypje të mirë e jo më kur shijon gatimet tradicionale e sidomos gatimet tradicionale të zonës si dhe peshkun e liqeneve të Dumresë të pjekur në zgarë e plot mishra të llojeve të tjerë. Në njësitë administrative nuk ka aktivitete të veçanta të organizuara për të tërhequr turistët përvec njërit fshat që është Seferani.

Turizmi është një ndër drejtimet më premtuese të zhvillimit ekonomik të qytetit të Belshit. Qyteti trashëgon nga e kaluara një varg të gjatë e të pasur vlerash historike, kulturore, etnografike, arkitektonike dhe natyrore, të tilla që përbëjnë një potencial të konsiderueshëm për turizmin. Me burimet turistike të qytetit është e mundur që të zhvillohet turizmi familiar dhe ai i organizuar (Doka,DH., 2019). Në Belsh 41 disa fshatra, mund të zhvillohet turizmi liqenor, i cili vitet e fundit ka patur interes në rritje për këtë lloj turizmi në zonën e Dumresë. Për të shtuar numrin e vizitorëve ka nevojë për sa më shumë investime sidomos; - një infrastrukturë rrugore që të bëj të mundur

lidhjen e të gjithë liqeneve kryesore dhe shtimin e sinjalistikës rrugore për të orientuar lëvizjen e turistëve (Doka,DH., 2019). Në përgjithësi, në zonën rurale, megjithëse ka burime ujore, nuk ka infrastrukturë të përshtatshme për sigurimin e ujit në kushte higjenike dhe brenda standarteve të lejuara.

Që në vitin 2016 filluan një sërë investimesh në Belsh nga Qeveria Shqiptare, me donatore vendas dhe të huaj për zhvillimin turistik të zonës së Dumresë, të cilët e kthyen në një destinacion të ri turistik. Disa nga investime në fushën e turizmit (S.T.K, Bashkia Belsh) janë;

- ✓ Projekti i Rilindjes Urbane;
- ✓ Shtegu i Biçikletave në fshatin Seferan;
- ✓ Ndërtimi i bustit të Perëndeshës Afërdita në Seferan dhe Amfiteatrit;
- ✓ Ndërtimi i 2 Bujtinave;
- ✓ Ndërtimi i pedonales , korsi bicikletash, (Qender – Belsh);
- ✓ Projekti i qeverisë për "100 Fshatrat" turistikë , ku për Bashkinë Belsh do të jetë fshati Seferan Ndërtim – asfaltimi i Unazës së qytetit te Belshit;
- ✓ Ndërtim – asfaltimi i rrugës nacionale; Cerrik – Belsh - Kucove - Ura Vajgurore, etj.

Duke qënë se Belshi ka qënë i panjohur, i pazbuluar dhe i paeksplorueshëm më parë, bashkia ka iniciuar aktivitete të rëndësishme në qytet me qëllim promovimin e qytetit dhe mundësive turistike që ofron. Promovimi i qytetit ka ndikuar në rritjen e numrit të vizitorëve në Belsh, ku vetëm në v.2018 e vizituan mbi 30 mijë vizitorë (S.T.K, Bashkia Belsh). Nga çdo sezon turistik shifrat e vizitorëve në Belsh vazhdojnë të rriten, ku dhe sot çdo fundjavë Belshi mbushet me vizitorë nga çdo zonë e Shqipërisë apo nga trevat shqiptare si dhe nga turistë të huaj.

Normalisht që zhvillimi i turizmit në Belsh, ka ndikuar në rritjen ekonomike për gjithë Dumrenë, ku me të prekur nga turizmi janë personat apo bizneset e përfshira në këtë sektor. Siç e thamë dhe pak më lartë që bizneset e vogla si; baret, restorantet kanë fituar shumë nga ky zhvillim i madh i turizmit në Belsh. Pra, turizmi shihet si një prespektivë mjaft pozitive për një zhvillim sa më të mirë socio-ekonomik (Doka, Dh., 2019). Sepse aktivitetet turistike konsiderohen si një nga burimet kryesore të rritjes ekonomike (Khalil.S et al., 2007), për shkak se vitet e fundit turizmi është rritur duke u kthyer në një aktivitet me dimensione të rëndësishme, duke marrë një vend të spikatur në ekonomitë e shumë vendeve të botës (Doka, Dh., 2019) dhe normalisht edhe për Shqipërinë në përgjithësi e sidomos për bashkinë Belsh, ky aktivitet po merr rëndësinë dhe vendin që i takon në sektorët ekonomik. Turizmi është gjithashtu një degë e tregtueshme që ndikon në industri të ndryshme shërbimesh si; transporti, shitja me pakicë, shitja me shumicë, restorantet, prodhimi bujqësor, etj (Konishi, Y., 2019), pra zhvillimi i turizmit do të thotë një zhvillim i shumëanshëm në ekonomi.

III. Llojet e turizmit që zhvillohen falë potencialeve natyrore dhe kulturore të zonës

Siç e kemi përmendur dhe më lart, kohët e fundit kjo degë ekonomike po njeh një zhvillim të shpejtë falë potencialeve të shumta natyrore dhe kulturore që zona e Dumresë mbart (Doka, DH., 2016). Destinacioni më i vizituar në të gjithë hapësirën gjeografike të Dumresë është qyteti i Belshit. Qyteti vizitohet më së shumti gjatë fundjavave, por normalisht që vizitoret nuk mungojnë

edhe gjatë ditëve të javës. Vendet më të preferuara në Belsh për vizitorët (S.T.K, Bashkia Belsh) janë:

- Pedonalja e qytetit;
- Liqeni i Luleve;
- Liqeni i Merhojes;
- Bujtinat në fshatin Seferan;
- Amfiteatri dhe Busti i Afërditës;
- Mali i Gradishtës;
- Liqeni dhe Pylli i Marinzës.

Këto burime turistike (natyrore/kulturore) janë promovuar vazhdimisht dhe rezultatet janë të dukshme, sepse kanë favorizuar zhvillimin e disa lloje të turizmit si;

Turizmi liqenor – Ajo që bie në sy për vizitorët pikë së pari janë 85 liqenet piktoreske në territorrin e Dumresë, bukuria e të cilëve kanë tërhequr vëmendjen e vizitorëve të ndryshëm, vendas dhe të huaj. Sipas autorit Hall "Liqenet janë një element thelbësor i disa prej destinacioneve turistike më të njohura në botë" (Hall, C.M., 2006), elementi më karakteristik i Dumresë, ku disa nga liqenet më piktoreskë të kësaj zone janë: – Liqeni i Belshit, Mërhojes, Seferanit, Cestijes, Degës, Liqeni i Kuq, Paraskës, i Marinzës etj.

Agroturizmi – ose sic e njohim ndryshe turizmi rural, ka në bazë motivet që i shtyjnë njerëzit të përjetojnë atmosferën që të ofron fshati me peizazhin rural (natyror ose i humanizuar), jetën bujqësore, kulinarinë, kulturën dhe etnografinë e zonës (Doka, Dh., 2019). Ky lloj turizmi me ndërmarrjen e strategjive për zhvillimin e zonave rurale, ofrojnë diversitet në ekonominë

kombëtare, ku industria e turizmit bëhet në mënyrë drastike si sektori i dytë më i rëndësishëm pas industrisë së rëndë (Marzuki, A., 2010), dhe në fakt kjo gjë po vërehet edhe në zonën e Dumresë, ku turizmi po bëhet sektori i dytë më i rëndësishëm pas bujqësisë. Agroturizmi zhvillohet më shumë në Seferan, i cili është destinacioni më i preferuar dhe më i vizituari në Dumre për këtë lloj turizmi.

Turizmi natyror – ose ndryshe ekoturizmi, sipas autorëve West dhe Carrier " Ekoturizmi është një biznes i madh dhe duket të jetë sektori me rritje më të shpejtë në industrisë turistike" (West, P. & Carrier, J.G., 2004). Dumrea njihet për një peizazh tipik rural, ku format e relievit të ndërthurura me bimësinë, liqenet e vendbanime formojnë peizazhe të mrekullueshme. Një shmb tipik është Pylli i Marinës, një destinacion perfekt për këtë lloj turizmi, ku janë të shumtë personat, që e vizitojnë pyllin për një xhiro qetësuese duke shijuar dhe pamjen magjepsëse që të ofron natyra.

Turizmi vizitonjës (kulturor) – Zona e Dumresë të befason me pasuritë arkeologjike sidomos në Seferan, ku gjendet, Statuja e Perëndeshës së Bukurisë "AFERDITA", Amfiteatri në breg të liqenit Seferan, Mali i Gradishtës, i quajtur ndryshe "Akropoli" i Dumresë etj. Kohët e fundit në fshatin Rrasë është zbuluar një termë e shek. II, me qeramikë e gurë dhe është regjistruar si një vendbanim Romak, i cili ka shërbyer si një vendpushim e banim i karvaneve të kohës. Vendbanime të tilla deri më tani në Shqipëri janë identifikuar në Butrint dhe Dyrrah (Durrës). Nga ky zbulim pritet zhvillimi akoma dhe më shumë i turizmit arkeologjik, në një të ardhme shumë të afërt (S.T.K, Bashkia Belsh). Dumrea mbart një kulturë të pasur, e cila shprehet në larminë e valleve, këngëve, veshjeve si dhe të festave të shumta. Çdo familje belshake ruan kostumet e veta popullore, të cilat i përdorin në raste festash e ditë të veçanta. Shumë turistë e vizitojnë Dumrenë vetëm për tu njohur me

kulturën e larmishme të zonës si dhe për të shijuar shfaqet folklorike që organizohen më rastin e festave të ndryshme.

Turizmi kulturor shihet si një premisë për zhvillimin e turizmit akoma dhe më shumë në të ardhme, i cili favorizohet nga pasuritë kulturore të përmendura me sipër. Por autor të ndryshëm e shohin këtë lloj turizmi më sy kritik, sepse cënon identitetin autokton të një vendi. Si prsh;

- ✓ Hughes thot "megjithëse mundësia për të përjetuar kultura të ndryshme mbetet një nga përfitimet kryesore të udhëtimit ndërkombëtar, kultura dhe turizmi shihen të kenë një marrëdhënie krejtësisht shkatërruese" (1989 cit. në McIntosh, A. J. et al., 2002)
- ✓ Johnston thot "Turizmi argumentohet të jetë kërcënimi kryesor për atdhe dhe kultura autoktone, nëpërmjet shfrytëzimin, dislokimin dhe përdhosjen e tij" (2000 cit. në McIntosh, A. J. et al., 2002)

Edhe pse autorët e shohin më sy kritik, për ekonominë e zonës kjo është një mundësi shumë e favorshme për zhvillim.

IV. KONKLUZIONE

Dumrea, është një zonë me potenciale të shumta natyrore e kulturore, e cila ofron shumë mundësi për zhvillimin ekonomik të zonës. Sic u trajtuam në punim, turizmi është një nënsektor me mjaft premisa pozitive për tu zhvilluar në të ardhme. Pikërisht ky aktivitet solli shpresë për zhvillim në sytë e banorëve që jetojnë në këtë zonë. Edhe pse rëndësi ka marr vetëm këto 4 vitet e fundit, praktikimi i këtij aktiviteti, e ka shndërruar Dumrenë në destinacionin me të ri turistik. Me ndihmen e investimeve të shumta që janë derdhur nga Bashkia Belsh në favor të këtij aktiviteti, qyteti i Belshit, qendra e Dumresë është rikonstruar dhe kthyer në një perlë të magjishme, e cila ka tërhequr vëmendje e mijërave turistëve, të cilët e rivizitojnë disa herë në vit këtë zonë duke e zbuluar gjithnjë e më shumën perlën e harruar të Shqipërisë dhe Mesdheut. Pasuritë natyrore dhe kulture që Dumrea mbart në vetvete janë baza e turizmit, sepse fal tyre në këtë zonë praktikohen disa lloje turizmi duke filluar nga turizmi natyror, kulturor, liqenor e deri te agroturizmi. Rëndësia e turizmit sa vjen e rritet githnjë e më shumë, aq sa në Dumre po bëhet aktiviteti i dytë më i rëndësishëm ekonomik pas bujqësisë, sepse të ardhurat që vijnë nga ky aktivitet janë shumë të larta. Bashkia Belsh ka ndërmarra politika për zhvillimin akoma dhe me shumë të turizmit sidomos pas zbulimit të vendbanimit romak në fshatin Rrasë.

Nga realizimi i këtij punimi dolëm në konkluzion se; - ***turizmi është aktiviteti që ka risjellur në jetë Dumrenë, duke e shndërruar në destinacionin më të vizituar të momentit në Shqipëri dhe nëse vazhdon kështu edhe në vitet e ardhshme qyteti i Belshit dhe e gjithë Dumrea do të njohi një zhvillim të madh duke e kthyer në një stacion të rëndësishëm turistik në Shqipëri.***

V. REKOMANDIME

Dumrea, si një zonë shumë e pasur me potenciale natyrore dhe kulturore, Bashkia Belsh duhet të hartojë si dhe zbatojë strategji të bazuara në kushtet reale të ekosistemit, në mënyrë që të arrijnë një zhvillim sa më të qëndrueshëm turistik si dhe ekonomik. Kjo zonë dallohet për problematika të shumta që e pengojnë zhvillimin e turizmit në vecanti dhe atij ekonomik në përgjithësi. Për të arritur një zhvillim turistik, në mënyrë që qyteti i Belshit dhe e gjithë Dumrea do të njohi një zhvillim të madh duke e kthyer në një stacion të rëndësishëm turistik në Shqipëri, rekomandojme;

- Të përdoren me racionalitet dhe të ruhen pasyritë natyrore;
- Të shtohen masat për ripyllëzim sidomos në zonat kodrinore në të cilat nuk praktikohet frutikulture, duke krijuar hapsira për realizimin e aktiviteteve shplodhëse si; krijimi i shtigjeve për shëtitje, krijimi i hapsirave për piknik me standartet europiane, etj;
- Të merren masa për mbrojtjen e hapsirave të gjelbra nga ndotja, sidomos në hapsirat që vizitohen më shumë, për një peizazh sa më të pastër për syrin e njeriut;
- Të shtohen investimet në hapsirat e tjera të Dumresë, të cilat mbartin potenciale turistike në mënyrë që turistët, të cilët rikthehen sërish këtu të kenë më shumë hapsira për ti vizituar dhe jo vetëm qendrën e Dumresë;
- Të ndërmerren masa e politika strategjike për zhvillimin e aktiviteteve të tjera ekonomike, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në turizmi si; të përmisohet cilësia e shërbimeve, të përmisohet infrastruktura, bujqësia etj, për të arritur një zhvillim ekonomik të shumëanshëm në të gjithë hapsirën gjeografike të Dumresë; etj.

VI. BIBLIOGRAFIA

1. Akademia e Shkencave. (1990). Gjeografia fizike e Shqipërisë II
2. Doka. Dh. (2019). Gjeografia e Turizmit
3. Hall, C.M., (2006). Lake tourism: An integrated approach to lacustrine tourism systems. Retrieved November 10, 2021, from; https://www.researchgate.net/publication/292429738_Lake_tourism_An_integrated_approach_to_lacustrine_tourism_systems
4. Khalil, S., Kakar, M. K., Waliullah, & Malik, A. (2007). Role of Tourism in Economic Growth: Empirical Evidence from Pakistan Economy [with Comments]. *The Pakistan Development Review*, *46*(4), 985–995. Retrieved November 10, 2021, from; http://www.jstor.org/stable/41261208
5. Konishi, Y. (2019). Global Value Chain in Services: The Case of Tourism in Japan. *Journal of Southeast Asian Economies*, *36*(2), 183–203. Retrieved November 10, 2021, from; https://www.jstor.org/stable/26798832
6. MARZUKI, A. (2010). TOURISM DEVELOPMENT IN MALAYSIA.: A REVIEW ON FEDERAL GOVERNMENT POLICIES. *Theoretical and Empirical Researches in Urban Management*, *5*(8 (17)), 85–97. Retrieved November 14, 2021, from; http://www.jstor.org/stable/24872612
7. McIntosh, A. J., Hinch, T., & Ingram, T. (2002). Cultural Identity and Tourism. *International Journal of Arts Management*, *4*(2), 39–49. Retrieved November 14, 2021, from; http://www.jstor.org/stable/41064754

8. Savage, M. (1993). Ecological Disturbance and Nature Tourism. *Geographical Review*, *83*(3), 290–300. Retrieved November 14, 2021, from; https://doi.org/10.2307/215731
9. Plani i Pergjithshem Vendor i Bashkisë Belsh, 2019
10. Plani operacional për zhvillimin lokal, Bashkia Belsh, Mars 2016, Sektori i Turizmit dhe Kulturws, Bashkia Belsh
11. West, P., & Carrier, James G. (2004). Ecotourism and Authenticity: Getting Away from It All? *Current Anthropology*, *45*(4), 483–498. Retrieved November 14, 2021, from; https://doi.org/10.1086/422082
12. White, W. B., Culver, D. C., Herman, J. S., Kane, T. C., & Mylroie, J. E. (1995). Karst Lands. *American Scientist*, *83*(5), 450–459. Retrieved November 10, 2021, from; http://www.jstor.org/stable/29775522